

Nr. _____ Prot, Tiranë, më _____.____.____

Nr. _____ Prot, _____, më _____.____.____

KONTRATË FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Sot më datë ____ / ____ / ____ , në _____, nënshkruhet kjo kontratë e furnizimit me energji elektrike midis palëve:

Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., shoqëri aksionere, regjistruar në 30.03.2018 në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530029T, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z./znj. _____, në cilësinë e **“Furnizuesit”**

dhe

Shoqërisë/ Personit Fizik “_____” _____, regjistruar në _____ në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS _____, me seli _____, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z./znj. _____, në cilësinë e **“Klientit”**

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike me të cilin Furnizuesi furnizon Klientin me kod kontrate _____, për vitin 2026 është _____ **Lekë/kWh pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës është me afat të pacaktuar.

Sasia e energjisë që shitet dhe blihet për pikën e livrimit _____, në sasinë totale vjetore (afërsisht) _____ kWh.

Furnizimi i energjisë së kontraktuar fillon më _____.____.2026 në orën 00:00.

Kontaktet:

Furnizues: Tel: _____ /email: _____

Klient: Tel: _____ / email: _____

BAZA LIGJORE:

- Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 124, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar;

- Vendimi Nr. 121, datë 04.04.2023 i Entit Rregullator i Energjisë “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. (FTL SH.A.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;
- Vendimi Nr. 113, datë 08.07.2016 i Entit Rregullator të Energjisë “Rregullore mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike“, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 181, datë 10.11.2017 i Entit Rregullator të Energjisë “Rregullore për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”;
- Vendimi Nr. 203, datë 18.12.2017 i Entit Rregullator të Energjisë “Rregullorja mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

DUKE QENË SE:

- Furnizuesi është person juridik, i cili ushtron veprimtarinë e tij tregtare konform legjislacionit shqiptar, në fushën e blerjes, menaxhimit të energjisë dhe operimin në tregun e lirë etj.
- Furnizuesi ushtron aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të klientëve në treg të lirë në Shqipëri dhe jashtë saj në përputhje me kushtet e licencës Nr. 423, Seria F18/F23, rinovuar nga Enti Rregullator i Energjisë me Vendimin Nr. 121, datë 04.04.2023.
- Klienti _____ zhvillon aktivitet _____ dhe ka shprehur interesin që të furnizohet me energji elektrike në njësinë e tij të ushtrimit të aktivitetit me vendndodhje në _____, Shqipëri.

Termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike janë pjesë përbërëse dhe të pandashme të kësaj kontrate.

Palët pasi u njohën me kushtet e veçanta, termat dhe kushtet e përgjithshme të kësaj Kontrate furnizimi me energji elektrike, me vullnet të lirë e të plotë bien dakord për nënshkrimin e saj.

PALËT:

FURNIZUESI
“Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A.

KLIENTI
“ _____ ”

Administrator

TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERNGJI ELEKTRIKE

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj kontrate, fjalët dhe termat e mëposhtme do të kenë kuptimet e përcaktuara këtu, përveç rasteve kur në këtë kontratë shfaqet një kuptim i kundërt. Sipas kontekstit të kontratës, përkufizimet mund përdoren në njëjës, shumës, në gjininë mashkullore apo femërore:

- 1.1 Enti Rregullator i Energjisë** ose “ERE”- është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin Nr. 43/2015 “Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
- 1.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose “OSSH” SH.A.** – është personi juridik, përgjegjës për operimin e sigurt të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë.
- 1.3 Operator i Sistemit të Transmetimit ose “OST” SH.A.** - është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.
- 1.4 Furnizim** - është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike të klientët.
- 1.5 Furnizues** - është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.
- 1.6 Energji Elektrike Aktive** - është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe dhe përcaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës. Njësia matëse e saj është Vat-Orë ose shumëfisha të saj.
- 1.7 Energji Elektrike Reaktive** - është integrali i caktuar me kufi kohë i Fuqisë reaktive matur në njësi me volt-amper reaktive—ore ose shumëfisha të saj. Nëse kapaciteti i instaluar i transformatorit të fuqisë është mbi 50 kVA, atëherë llogaritet vlera e energjisë elektrike aktive në varësi të energjisë reaktive të përdorur dhe të çliruar me faktor mesatar mujor të kapacitetit më të vogël se 0.9 gjatë ditës.
- 1.8 Konsumi** - do të thotë sasia e energjisë elektrike që konsumohet nga Klienti për çdo periudhë shlyerje.
- 1.9 CET-** Central European Time (përcakton zonën kohore të Evropës Qendrore), orari zyrtar i leximit të sistemit të matjes.

- 1.10 Sistem matës** - është tërësia e pajisjeve të matjes: matësi, automati, transformatorët e matjes, mbrojtësit e matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes të të dhënave, pajisjet e shpërndarjes dhe komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike reaktive në pikën e matjes.
- 1.11 Programim** - programim do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimit të energjisë elektrike. Në këtë kontratë, Programimi nënkupton një Program Javor/Mujor për livrimin e energjisë që i paraprin javës/muajit në të cilën sasia e energjisë në program do të livrohet nga Furnizuesi tek klienti.
- 1.12 Forcë madhore** - është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
- 1.13 Përfaqësues i autorizuar** - personi i ngarkuar zyrtarisht nga secila palë për ndjekjen e kësaj Kontrate.
- 1.14 Pikë karikimi** - është një ndërfaqe publikisht e aksesueshme që është e aftë të karikojë një automjet elektrik në një kohë të vetme ose të ndërrojë baterinë e një automjeti elektrik njëkohësisht.
- 1.15 Operator tregu** - është subjekti i licencuar nga ERE për organizimin dhe operimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut brenda së njëjtës ditë.
- 1.16 Vetëprodhues** - është konsumatori përfundimtar që prodhon energji elektrike të rinovueshme për konsumin e vet, që mund të depozitojë ose të shesë energji elektrike të rinovueshme të vetëprodhuar, me kusht që për vetëprodhuesin e burimeve të rinovueshme këto aktivitete nuk përbëjnë veprimtarinë kryesore komerciale ose profesionale.
- 1.17 Bilanc vjetor për vetëprodhuesit** - nënkupton tepricën e energjisë elektrike të injektuar në rrjet (1.8.0 – 2.8.0), e cila llogaritet duke filluar nga momenti (muaji) kur krijohet kjo tepricë dhe përfshin të gjithë muajt në vazhdim, deri më datë 31 Dhjetor të të njëjtë vit kalendarik.
- 1.18 Rregullat e tregut** - janë rregulla të hollësishme, të cilat përcaktojnë mënyrën e operimit dhe menaxhimit të tregut, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit, rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e tregut.

1.19 Përputhja me aktet nënligjore dhe rregullat e tregut - kjo Kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontratë është garantimi i furnizimit të pandërprerë me energji elektrike nga Furnizuesi dhe detyrimi i Klientit për të paguar sasinë e energjisë së konsumuar në pikën/at e livrimit të rrjetit në përputhje me çmimin për njësi të përcaktuar.

Neni 3

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike

- 3.1** Çmimi i shitjes së energjisë elektrike me të cilin Furnizuesi furnizon Klientin është vjetor. Furnizuesi e publikon vendimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike, nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara aplikimit.
- 3.2** Çmimi i shitjes së energjisë elektrike me të cilin Furnizuesi furnizon Klientin llogaritet bazuar në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes për njësi të energjisë elektrike”, e miratuar nga organet kompetente vendimmarrëse. Në rast se, për të furnizuar klientët, nevojitet të sigurohet energji shtesë në treg të parregulluar, atëherë kosto e blerjes mbi të cilin llogaritet çmimi i shitjes me të cilin Furnizuesi furnizon Klientin do të jetë i barabartë me çmimin e ponderuar me të cilin është siguruar kjo energji.
- 3.3** Çmimi i shitjes së energjisë elektrike do të aplikohet për energjinë aktive dhe reaktive.
- 3.4** Çmimi i shitjes së energjisë elektrike aktive dhe reaktive do të jetë objekt rishikimi nëse Enti Rregullator i Energjisë ndryshon tarifat e shërbimit të transmetimit dhe/ose të shpërndarjes së energjisë elektrike, çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin përkatës, rishikon aplikimin e çmimit reaktiv nga “OSSH” SH.A. për klientët me fuqi mbi 50 kVA për kompensimin e energjisë reaktive në rrjetin e shpërndarjes apo miraton tarifa të tjera.

Neni 4

Lidhja e Kontratës dhe kohëzgjatja e saj

- 4.1** Ka të drejtë të kërkojë lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike me shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. çdo klient që ka një pike lidhje të miratuar me rrjetin e energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin e Sektorit të Energjisë

Elektrike si dhe që ka ekzekutuar të gjitha detyrimet në raport me Furnizuesin e mëparshëm ose ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë me të, bazuar në Rregulloren mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë.

- 4.2** Kjo kontratë është me afat të pacaktuar dhe secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë, duke njoftuar palën tjetër jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara fillimit të livrimit për muajin pasardhës.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Klientit

5.1 Klienti ka të drejtë:

- a) të informohet për konsumin e tij aktual dhe kostot respektive të energjisë elektrike, në varësi të pajisjeve matëse, me të cilat është i pajisur. Ky shërbim ofrohet pa kosto shtesë;
- b) të marrë informacion për konsumin faktit mujor dhe detyrimet financiare, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesës;
- c) të paraqesë një ankim pranë Furnizuesit për çdo veprim apo mosveprim të Furnizuesit që lidhet me drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë, me shkrim, e-mail ose pranë zyrave të Kujdesit ndaj Klientit të OSHEE Group SH.A.;

5.2 Klienti ka detyrimin:

- a) të paguajë vlerën e faturës tatimore të energjisë elektrike jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e lëshimit të faturës nga Furnizuesi në përputhje me kushtet e kontratës;
- b) të njoftojë Furnizuesin brenda 1 (një) orë nga momenti i ndërprerjes së energjisë elektrike për arsye defekti në rrjetin e Klientit;
- c) të njoftojë Furnizuesin 10 (dhjetë) ditë përpara, nëse do të kërkojë rritjen ose zvogëlimin e sasisë të energjisë elektrike që do të furnizohet gjatë vlefshmërisë së kësaj kontrate dhe ose ndalim për t'u livruar si pasojë e mirëmbajtjes ose riparimeve;
- ç) të njoftojë Furnizuesin 30 (tridhjetë) ditë përpara kur planifikon të bëjë përmirësim teknologjik;
- d) t'i mundësojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ose Operatorit të Sistemit të Transmetimit instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të energjisë elektrike.

5.3 Klienti duhet t'i dërgojë Furnizuesit, me e-mail, skedulet ditore të përbëra nga kapaciteti i energjisë se konsumueshme në datën e përcaktuar të livrimit jo më vonë se ora 15.00 CET, 2 (dy) ditë pune para datës së livrimit. Në çdo moment ndërmjet datës së dorëzimit të skedulit dhe datës së livrimit, Klienti ka të drejtë t'i paraqesë Furnizuesit kërkesë për ndryshimin e programit.

5.4 Nëse Klienti nuk dërgon apo dështon në dërgimin e programit/ skedulit të energjisë elektrike për ditën në avancë (D+1), në adresën elektronike info.furnizimi@oshee.al, brenda orës 10:00, do të jetë Furnizuesi ai që do të kryejë programimin/ skedulimin e konsumit të

energjisë elektrike. Në këtë rast, Klienti nuk do të ketë asnjë pretendim mbi programimin/skedulimin e kryer nga Furnizuesi.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Furnizuesit

6.1 Furnizuesi ka të drejtë:

- a) të kërkojë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga OSSH SH.A., pasi e ka njoftuar klientin me shkrim ose email, sipas përcaktimeve të kësaj kontrate, në rastet kur klienti nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë
- b) të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike, duke njoftuar me shkrim/ email klientin, nëse Klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj Furnizuesit nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas nenit 5.2, shkronja “a” të kësaj kontrate.

6.2 Furnizuesi ka detyrimin:

- a) të furnizojë klientin me energji elektrike, në përputhje me kontratën e nënshkruar me kushte të njëjta të furnizimit me energji elektrike, në mënyrë të sigurt, jodiskriminuese, të besueshme dhe efikase;
- b) të furnizojë klientin me energji elektrike në pikën e livrimit;
- c) t'i kërkojë operatorit të rrjetit të bëjë rilidhjen e energjisë elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike;
- ç) të informojë Klientin për:
 - konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e tij;
 - mënyrat e ndryshme të pagesës dhe sistemet e parapagimit, nëse aplikohen.

Neni 7

Faturimi dhe pagesa

7.1 Furnizuesi, në përfundim të muajit të livrimit për një periudhë kohore prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike, pas rakordimit me operatorin e tregut dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes duhet t'i dorëzojë Klientit, në adresën e përcaktuar në këtë kontratë, faturën e energjisë elektrike, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e fundit e livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Në rast se ka kontestime, Klienti mund t'i paraqesë Furnizuesit një ankesë lidhur me saktësinë e të dhënave, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita që “FTL” SH.A., i ka dorëzuar faturën tatimore të energjisë elektrike.

7.2 Faturimi për klientët të cilët kanë të instaluar impiant fotovoltaik vetëprodhues bëhet bazuar në bilancin vjetor për vetëprodhuesit. Mënyra e faturimit për vetëprodhuesit do të ndryshojë me miratimin e akteve nënligjore dhe rregullatore.

- 7.3** Furnizuesi, do t'i dorëzojë Klientit për konsumin e energjisë elektrike faturën tatimore sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të energjisë elektrike të shitur prej tij në periudhën kohore të livrimit.
- 7.4** Pagesa e faturës duhet të bëhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e lëshimit të saj. Pagesa do të bëhet në Lekë në llogaritë bankare të Furnizuesit. Në të gjitha rastet, Klienti është përgjegjës për pagesën e plotë të të gjitha faturave të lëshuara sipas parashikimit të këtij neni.
- 7.5** Palët bien dakord që në rast të pagesave të paidentifikuara të bëra nga Klienti apo mbipagesave të tjera të faturës/ave, Furnizuesi ka të drejtë të balancojë detyrimet aktuale apo të mbartura të Klientit dhe shuma përkatëse të konsiderohet si parapagesë e detyrimeve të muajit pasardhës të Klientit.
- 7.6** Një detyrim i pasaktë në faturë, duhet të ndryshohet nga Pala e cila ka lëshuar faturën, në faturën tjetër pas gjetjes së gabimit, për ta ndrequr atë. Shkaqet e gabimit mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga:
- a) ndërhyrje në matës;
 - b) matësa të dëmtuar, lexim i matësit të dëmtuar;
 - c) gabime nga Operatori i Sistemit në lidhje me detyrimet ndaj Furnizuesit;
 - ç) gabime në konsumin e faturuar të energjisë elektrike të Klientit;
 - d) ndryshimet midis leximeve të vlerësuara të matësit dhe të dhënat e matësit të marra pasi është lëshuar fatura.
- 7.7** Me përfundimin apo zgjidhjen e kontratës, palët kryejnë rakordimin final ndërmjet tyre, i cili duhet të shoqërohet me përmbushjen e të gjitha detyrimeve që Klienti ka ndaj Furnizuesit. Ky proces duhet të kryhet brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga përfundimi apo zgjidhja e kësaj kontrate.

Neni 8

Pasojat e mospagesës

- 8.1** Pas kalimit të afatit të pagesës të përcaktuar në nenin 7.4 të kësaj Kontrate, Klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e faturës.
- 8.2** Me kalimin e afatit të pagesës së përcaktuar në këtë kontratë, Furnizuesi ka të drejtë që të kërkojë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim/email këtë të fundit 48 (dyzet e tetë) orë përpara në adresat e përcaktuara në kontratë. Pas shlyerjes së detyrimit dhe me kërkesë të Klientit, Furnizuesi është i detyruar që të kërkojë rilidhjen brenda 48 (dyzet e tetë) orëve.
- 8.3** Nëse Klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj Furnizuesit, do të merren masat për fillimin e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, duke kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit,

sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit Nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 9

Mos-performance

- 9.1** Në rast se Furnizuesi nuk arrin të livrojë sasinë e kontraktuar të energjisë elektrike tërësisht ose pjesërisht (përveç për shkak të Forcës Madhore ose për shkak të rrethanave për të cilat është përgjegjës Klienti), Furnizuesi duhet t'i furnizojë Klientit në formë kompensimi sasinë e energjisë elektrike të palivruar.
- 9.2** Parashikimi i mësipërm do të aplikohet në çdo rast kur Furnizuesit i njihet kompensim si rrjedhojë e:
- a) ndërprerjeve të paplanifikuara të energjisë nga “OSSH” SH.A. ose “OST” SH.A.;
 - b) kur “OSSH” SH.A. është e detyruar të realizojë kufizime në shpërndarjen e energjisë elektrike me qëllim ruajtjen e sigurisë së sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
 - c) kur “OSSH” SH.A. është e detyruar të realizojë kufizime në shpërndarjen e energjisë elektrike në përputhje me udhëzimet e “OST” SH.A.
- 9.3** Furnizuesi njofton Klientin për ndërprerjet e paplanifikuara të energjisë nga “OSSH” SH.A. ose “OST” SH.A. brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja dijeni e ngjarjes që është bërë shkak për ndërprerje.
- 9.4** Në rastet e ndërprerjeve të planifikuara të energjisë nga “OSSH” SH.A. ose “OST” SH.A. sipas programit vjetor të remonteve, Furnizuesi do të njoftojë Klientin jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të muajit në të cilin parashikohet kryerja e punimeve të mirëmbajtjes, duke specifikuar zgjatjen e punimeve, objektin (vendin) ku do të kryhen këto punime.
- 9.5** Kur klienti që ka detyrimin për blerjen e energjisë elektrike ndryshon kapacitetin e përcaktuar në këtë kontratë, duke rritur sasinë e energjisë elektrike të programuar, rritje për të cilën Furnizuesi nuk disponon kapacitet, Klienti do t'i paguajë Furnizuesit si kompensim për dëmin një shumë të barabartë me:
- a) Në rastin kur Furnizuesi e siguron këtë energji nga tregu i parregulluar, Klienti do t'i paguajë Furnizuesit si kompensim për dëmin, një shumë të barabartë me sasinë shtesë mujore të livruar të energjisë elektrike shumëzuar me një vlerë të barabartë me diferencën ndërmjet çmimit të kontratës zëvendësuese dhe çmimit të kontratës objekt mosperformance, në rastin kur kjo diferencë është pozitive.
 - b) Në rastin kur Furnizuesi nuk e siguron këtë energji nga tregu i parregulluar, Klienti do t'i paguajë Furnizuesit si kompensim për dëmin, sasinë shtesë mujore të livruar të energjisë elektrike shumëzuar me një vlerë të barabartë me diferencën ndërmjet çmimit të disbalancës negative për periudhën e furnizimit në të cilën është kryer livrimi i energjisë, siç publikohet

në website-in e Operatorit të Tregut (www.ost.al) dhe çmimit të përcaktuar në këtë kontratë, në rastin kur kjo diferencë është pozitive.

- 9.6** Kur klienti, që ka detyrimin për blerjen e energjisë elektrike për periudhën objekt kontrate (me përjashtim të rasteve të forcës madhore), dështon në blerjen e saj, atëherë klienti duhet ti paguajë Furnizuesit diferencën pozitive midis çmimit të kontratës dhe çmimit me të cilin Furnizuesi e ka shitur në treg të parregulluar.

Neni 10

Instalimi, kontrolli dhe pronësia e sistemit matës

- 10.1** Matësi dhe/ose sistemi matës i instaluar tek Klienti nga operatori i rrjetit të shpërndarjes duhet të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për metrologjinë dhe pas instalimit duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, ose nga persona juridikë të autorizuar prej saj.
- 10.2** Klasa e saktësisë së matësve të energjisë elektrike përcaktohet në Kodin e Matjes, të miratuar nga ERE.
- 10.3** Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike brenda kufijve të pronës së tij.
- 10.4** Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të Furnizuesit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë apo personave juridikë të autorizuar. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- 10.5** Kur pas verifikimit, konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje të bëra nga Klienti, bëhen përlllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyra e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.
- 10.6** Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje të bëra nga klienti, nga ana e “OSSH” SH.A. merren masa për zëvendësimin e sistemit të matjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Njoftimet e palëve

Çdo njoftim ose komunikim që kërkohet ose lind si nevojë e zbatimit të kësaj Kontrate, do të jetë me shkrim, në rrugë postare, elektronike ose telefon.

Neni 12

Përfundimi i kontratës

- 12.1** Kjo kontratë mund të përfundojë me zgjidhje të njëanshme dhe të menjëhershme në rast të mospërbushjes thelbësore të detyrimeve nga palët e kësaj Kontrate.

12.2 Furnizuesi ruan të drejtën e përfundimit të mënjëhershëm të kontratës në rast të:

- a) lidhjeve abuzive në sistemin e matjes;
- b) lidhjes të një kontratë paralele me një Furnizues tjetër të ndryshëm nga “FTL” SH.A. pa njoftuar më përpara këtë të fundit;
- c) mospagesës nga Klienti të detyrimeve për energjinë elektrike në përputhje me afatet e kësaj kontrate.

12.3 Përfundimi i kësaj Kontrate, për çdo lloj shkak nuk cënon në vetvete të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj ose nga marrëveshje të tjera midis Palëve.

Neni 13

Konfidencialiteti

13.1 Kjo Kontratë dhe përmbajtja e saj i nënshtrohet trajtimit konfidencial dhe do të përhapen vetëm nëse kërkohet në mënyrë ligjore nga organet dhe/ose agjencitë shtetërore.

13.2 Të gjitha informacionet, dokumentet, materialet, të dhënat që i përkasin, zotërohen dhe i jepen Furnizuesit nga Klienti, gjatë kryerjes së shërbimeve, nëpërmjet të gjitha mjeteve dhe formave do të jenë subjekt i konfidencialitetit. Konfidencialiteti që përmbajnë këto dokumenta, materiale dhe të dhëna do të zbatohet gjatë dhe pas Kontratës, të paktën për një periudhë 3 (tri) vjeçare pas përfundimit ose zgjidhjes së Kontratës.

Neni 14

Transferimi

Asnjëra nga palët nuk duhet ti ngarkojë ose transferojë në asnjë mënyrë këtë Kontratë dhe ndonjë të drejtë, detyrë ose detyrim që rrjedh prej saj, ndonjë personi tjetër ose entiteti pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të palës tjetër, pëlqim, i cili nuk duhet të refuzohet ose vonohet pa shkak.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ligji i zbatueshëm

15.1 Çdo amendim ose shtesë në këtë kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët. Të gjitha këto amendime/shtesa do t'i bashkëlidhen Kontratës, si pjesë integrale e saj.

15.2 Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me Kontratën ose interpretimin e saj. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore, çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë, do të zgjidhet dhe do t'i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

15.3 Kjo Kontratë, kuptimi, interpretimi dhe marrëdhënia midis palëve do të zgjidhet sipas legjislacionit Shqiptar.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kontrata hyn në fuqi nga data e furnizimit me energji elektrike.